

# INDEKSI I ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BUJQËSORE

2025

Në vitin 2025, indeksi vjetor i çmimeve të prodhimeve bujqësore arriti në 151,2 nga 149,6 që ishte në 2024, duke shënuar një rritje me 1,0 %. Gjatë këtij viti, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore shënoi rritje me 1,4 %, pasuar nga indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale me rritje me 0,5 %, krahasuar me një vit më parë.

**FIG. 1 INDEKSI TREMUJOR I ÇMIMEVE TË PRODHIMEVE BUJQËSORE, (2015=100)**



Burimi: Anketa mujore për Produktet Bujqësore, INSTAT

## Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve Bujqësore](#)

# Metodologjia

Indekset e çmimeve të prodhimeve bujqësore llogariten bazuar në standartet dhe rregullat e përkshuara në Manualin e Çmimeve të Produkteve Bujqësore të Eurostat. Çmimet mbledhen nga Anketa Mujore për Produktet Bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Mbledhja e të dhënave kryhet pranë fermave, tregjeve të gjësë së gjallë, tregjeve të shumicës dhe vende të tjera ku prodhimet bujqësore mund të grumbullohen. Informacioni merret vetëm për çmimet në nivel ferme për produktet vendase, duke përjashtuar taksat. Ato janë mbledhur në Lek, kurse njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë sipas produktit.

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të produkteve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Për prodhimet bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë industriale, bimë foragjere, perime, patate dhe drufrutorë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për mishin peshë e gjallë dhe prodhimet blegtorale. Çmimet e mishit peshë e gjallë grumbullohen për katër kategori kryesore të kafshëve: gjedhi, të imta, derra dhe shpendë. Për prodhimet blegtorale, çmimet janë grumbulluar për kategoritë: qumësht, vezë dhe mjaltë.

## Skema e peshave në Indeks të çmimeve të prodhimeve bujqësore

Për llogaritjen e indeksit të çmimeve të produkteve bujqësore përdoret një skemë e mirëpërcaktuar peshash. Vlera e peshës bashkëngjitur në çdo indeks elementar dhe në indeksin e agreguar është e barabartë me vlerën e shitjes së produkteve (pa përfshirë TVSH) gjatë periudhës bazë (2015=100), bazuar kjo në metodologjinë ndërkombëtare. Peshat përdoren gjithashtu dhe për të bashkuar nëngrupet e indekseve në nivel grupi dhe për të agreguar indekset në nivel grupi duke prodhuar indeksin vjetor. Peshat e çmimeve të produkteve bujqësore janë konform parimeve të Llogarive Ekonomike në Bujqësi (në konceptin e çmimeve të prodhimit). Skema e peshave për Indeks të çmimeve Bujqësore ndryshon çdo 5 vite. Gjatë kësaj periudhe peshat totale dhe peshat tremujore të çmimeve të produkteve bujqësore nuk ndryshojnë.

## Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Indeksi elementar llogaritet sipas formule në vijim duke përdorur çmimet mesatare absolute.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0} \cdot 100$$

$R_i^t$  : Indeksi elementar për muajin "t" dhe prodhimin "i"

P : Çmimet e grumbulluara

i : Prodhimi "i"

j : Çmimi i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për rrethin 1.2.....n)

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë

### Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve

Indeksit të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është llogaritur duke shfrytëzuar formulën në vijim:

$$I^t = \sum (R_i^t \cdot \frac{w_i^o}{\sum w_i^o}) \cdot 100$$

I : Indeksi i agreguar për periudhën "t"

$w_i^o$  : Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin "i"

i : Prodhimi "i"

t : Muaji i vëzhguar

o : Muaji bazë